

# LEPTOSTAR 200 SL

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



“Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit”

**LEPTOSTAR** është insekticid sistemik me aktivitet të lartë citotropik-translaminar, që lejon mbrojtjen e organeve vegetative të reja të zhvilluara pas trajtimit. Efektiv në kontrollin e disa insekteve me aparat gojor shpues-thithes (afidet, aleuroidet, çikadat, tripset) dhe aparat gojor brerës (lepidopterët dhe koleopterët).

**Lënda vepruese:** *Acetamiprid 200 gr/lit.*

**Formulimi:** *Koncentrat i tretshëm (SL)*

## Masat parambrojtëse:

- P102: Mbajeni në vende të sigurta dhe të pa arritëshme nga fëmijët.
- P201: Merni udhëzimet e vecanta para përdorimit.
- P264: Lani menjehere pas trajtimit të gjitha pjesete e zbuluara të trupit dhe robat e kontaminuara.
- P270: Gjatë përdorimit të tij mos ha e mos pi ujë dhe duhan.
- P273: Shmangni shkarkimet dhe derdhjet në mjedis të preparatit..
- P280: Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze.
- P308+P311: Në rast ekspozimi dhe shqetesimi telefonini menjehere qendren me të afert shendetesore dhe konsultohuni me nje mjek.
- Lani paisjet mbrojtëse në përfundim të punës.
- EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet e përdorimit.
- P501: Mblidhni ambalazhet në kontenierë të veçantë dhe bëni shkatërrimin e tyre sipas rregullave në fuqi.

## Udhëzim për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- H302 - I dëmshëm në rast të gjëlltitjes.
- H317 - Në kontakt me lekuren mund të shkaktojë reaksion alergjik
- H319 - Shkakton acarim dëmtim serioz i syve .
- H332 – I dëmshëm nëse thithet
- H361d - Ka dyshime se demton fertilitetin apo femijen e palindur.
- H410 - Shumë toksike për jeten ujore me efektet afatgjata.
- EUH401 Zbatoni udhëzimet për përdorim për të shmangur rreziqet ndaj shëndetit njerëzor dhe mjedisit.

## Përdorimi:

**Në pemët frutore farore (mollë e dardhë):** për kontrollin e afideve, psillave, me 25-30 ml/100 lit ujë; minueseve, morrit të përgjakshëm, me 25-30 ml/100 lit ujë; krimbit të mollës, me 35-50 ml/100 lit ujë. Lejohen dy trajtime/sezon me intervale 8 ditë. Trajtimi i parë rekomandohet në fazën e veshëve të miut.

**Në bërthamore** (kajsi, pjeshkë, nektarinë): kundër afideve, çikalinave, tripsit, lepidopterëve, me 25-50 ml/100 lit ujë. Lejohen deri në dy trajtime/sezon me interval 20 ditë.

**Në qershi:** kundër afideve dhe mizës së qershisë, me 20-35 ml/100 lit ujë. Dy trajtime/sezon me interval 14 ditë.

**Në agrume:** kundër minatriçeve dhe afideve, me 35-50 ml/100 lit ujë; formave të mitura të breshkëzave, me 50-70 ml/100 lit ujë. Kryhen dy trajtime/vit me interval 30 ditë. Trajtimi i fundit në fillim të ngjyrosjes së frutave.

**Në vresht:** kundër *Empoasca vitis*, tenjës, me 30-45 ml/100 lit ujë.

**Në patate:** kundër afideve, bubrrecit të patates, me 20-30 ml/100 lit ujë. Dy trajtime/sezon me interval 7 ditë.

**Në perime në serra dhe fushë** (domate, kastravec, patëllxhan, spec): kundër afideve, me 0.25 lit/ha; krahë bardhave dhe tripseve, me 0.35-0.5 lit/ha; koleopterëve, me 35-50 ml/100 lit ujë. Aplikohen dy trajtime/sezon me interval 20 ditë.

**Në brokoli, lule lakër, lakër, marule eskariola, sallatë:** kundër afideve, me 0.25-0.35 lit/ha.

**Në duhan:** kundër afideve, me 30-50 ml/100 lit ujë.

**Ne jonxhe e foragjere:** kunder afideve me doze 30-50 ml/100 lit

**Ne Miser :** kunder *Ostrinia nubilalis*, *Aphis sp.* (*Rhopalosiphum maidis*) me doze 30-50 ml/100 lit uje.

### **Vërejtje për përdorimin:**

Përzihet me të gjithë insekticidet, me përjashtim të atyre me reaksion alkaline. Mos aplikoni në kohën e lëvizjes (fluturimit) të insekteve plenuese. Siguroni një lagje të plotë e të njëtrajtshme të sipërfaqes gjethore. Në rastet e përdorimit të vëllimit të ulët të ujit atëhere rritet përqendrimi i përzierjes në mënyrë që të ruhet doza e produktit për njësinë e sipërfaqes (ha) sikurse përdoret në trajtimet normale të volumit të spërkatjes.

### **Papajtueshmëria:**

Në rast të përzierjes me formulime të bazuara në substanca të reja aktive, kryeni analiza paraprake të përzierjes përpara përdorimit në sipërfaqe të mëdha.

Në rastet e përzierjeve me substanca të tjera, respektoni periudhën e pritshmërisë të produktit me afatin më të gjatë.

### **Ndikimi në ekosistem:**

Nuk është i dëmshëm për insektet e dobishme dhe bletën. H400: Shumë toksik për organizmat ujore. SP1: Mos ndotni ujin dhe burimet ujore me produktin ose ambalazhin e tij. Mos aplikoni spërktje pranë ujërave sipërfaqësore. Shmangni kontaminimin përmes sistemit të kullimit të ujit në ferma dhe rrugë. Për të mbrojtur organizmat ujore respektoni një brez të sigurisë që nuk trajtohet: 20 m gjelbërim në aplikimet në pemtore dhe perime; 10 m për aplikimet në patate dhe rrush. Për mbrojtjen e artropodëve jo-target, respektoni një rrip sigurie të patrajtuar në zonat e pakultivuara: 30 m për agrume, kajsi, nektarinë; 15 m për pjeshkën, kajsinë, qershinë; 10 m për vreshtin dhe kumbullën; 5 m për perimet, specin, patëllxhanin dhe domaten.

### **Karenca:**

Trajtimi fundit para vjeljes: 3 ditë në qershi, domate e patëllxhan në sera; 7 ditë për hardhinë dhe perimet në fushë të hapur (marule, radhiqe dhe sallata të tjera, patate, spec, domate, patëllxhan); 14 ditë për lule lakrën, brokolin, lakrën kokë, kajsinë, nektarinën, kumbullën; 28 ditë për pjeshkën; 30 ditë për agrumet dhe frutat e tjera; 60 ditë për greipfrutin, portokallin dhe mollën.

### **Magazinimi:**

Ruhet në ambjente të mbyllura dhe në temperaturë 0 deri 40° C.

Nr dhe data e regjistrimit: 53, datë; 24.02.2026

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: 1 deri 5 lit.

Data e prodhimit.....;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesëve të përcaktuara): 3 vjet

Numri i partise së mallit (serise) ose shenja të tjera identifikuese .....

Tipi i ambalazhit baze: shishe HDPE (High density polyethylene).

Emri dhe adresa e Aplikantit: QEMETICA Agricultural Solutions Poloni SA, ul. Chemików 1, 37-310 Nowa Sarzyna,

Emri dhe adresa e Fabrikuesit të PMB: QEMETICA Agricultural Solutions Poloni SA, ul. Chemików 1, 37-310 Nowa Sarzyna,

Emri dhe adresa e ambllazhuesit (kur ambllazhimi kryhet ne Republikën e Shqipërisë).....